**KËRKESË**
**Nr.3742/1, datë 17.10.2008**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Laç-Kisha Shënanout". Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët për të cilët në kolonën "shënime" në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 975 520 (nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet) lekë.

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LAÇ-KISHA E SHËNANOIT

| Nr. | Pronari | Zk | Nr. pas. | Lloji i pas. | Sip. $m^2$ | Çmimi lek/$m^2$ | Vlera lekë | Qyteti | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashkëpronarë | 2364 | 4/635 | Truall | 230 | 2144 | 493120 | Laç | Konfirmuar nga ZRPP |
| 2 | Bashkëpronarë | 2364 | 4/641 | Truall | 225 | 2144 | 482400 | Laç | Konfirmuar nga ZRPP |
| | **TOTALI** | | | | **455** | | **975520** | | |